

KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në ligjin nr. 72/2022, datë 20.10.2022, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 45/2015, ‘Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë’, të ndryshuar”, botuar në Fletore Zyrtare nr. 154, datë 17.11.2022, f. 18649, bëhet korrigjimi i gabimit material, si më poshtë:

- Pika 2 e nenit 7 të ligjit:

Ishte:

2. Pas fjalës “proceset politike” vendoset shprehja “apo dëshmitar i akuzës në proceset politike”; hiqet presja pas fjalës “politike të posaçme”, vendoset presje dhe më pas shtohet fjala “apo denoncues”.

Bëhet:

2. Pas togfjalëshit “proceset politike”, fjalët “denoncues apo dëshmitar i akuzës në proceset politike, të posaçme;”, zëvendësohen me fjalët “dëshmitar i akuzës në proceset politike të posaçme, apo denoncues;”.

- Pika 2 e nenit 8:

Ishte:

2. Në pikën 2, togfjalëshi “nga mbarimi i afatit” zëvendësohet me togfjalëshin “nga konstatimi i mbarimit të afatit”.

Bëhet:

2. Në pikën 2, togfjalëshi “nga mbarimi i mandatit” zëvendësohet nga togfjalëshi “nga konstatimi i mbarimit të mandatit”.